



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1600/prot.  
11

Tiranë, më 02.11.2020

V E N D I M

Nr. 42, datë 01.11.2020

“PËR

MIRATIMIN E PAGESËS SË ORËVE SUPLEMENTARE

TË STAFIT AKADEMIK, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në VKM nr. 748 datë 11.06.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në IPAL” të ndryshuar pika 7, në Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”, në shkresën e FVFR nr. 1517 prot, dt.20.10.2020 “Përcjellje e evidencave të realizimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik 2019-2020”; në shkresën e FSHL nr 1538 prot, dt. 20 .10 .2020“Përcjellje e evidencave të realizimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik 2019-2020”, në shkresën IKSHS nr. 1508, prot, dt. 20.10.2020“Realizimi i orëve mësimore, sipas mësimdhënies së normuar vjetore 2019-2020” në Vendimin e Senatit Nr. 25 datë 29.10.2020”mbi miratimin e propozimit për pagesën e orëve suplementare për vitin akademik 2019-2020”, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 02 .11.2020,

V E N D O S I:

1. Miratimin për pagesën e orëve suplementare të stafit akademik të tre njësive kryesore të UST, për vitin akademik 2019-2020, nga art 600.8 i buxhetit të Universitetit Sporteve të Tiranës, i planifikuar në miratimin e grandit, për vitin buxhetor 2020.
2. Miratimin për pagesën e stafit akademik për orën mësimore sipas pikës 7 të VKM nr. 748 datë 11.06.2009”Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në IPAL”, të ndryshuar.

3. Miratimin e pagesës së orëve suplementare deri në 100 orë të stafit të IKSHS, për vitin akademik 2019-2020 dhe në vijim.
4. Bashkangjitur dokumentacioni përkatës nga të tre njësitë kryesore
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi ,Administratori , Drejtoria e financës dhe buxhetit
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek portali i transparencës universitare.

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**HYSËN DOMI**

